



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada – Government*

---

**MEMORANDUM SHPJEGUES PËR PROJEKTLIGJIN PËR PËR RATIFIKIMIN E  
TRAKTATIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE MBRETËRISË SË  
DANIMARKËS PËR SHFRYTËZIMIN E INSTITUCIONIT KORREKTUES NË GJILAN ME  
QËLLIM TË EKZEKUTIMIT TË DËNIMEVE DANEZE**

**EXPLANATORY MEMORANDUM FOR THE DRAFT LAW ON THE RATIFICATION OF  
THE TREATY BETWEEN THE REPUBLIC OF KOSOVO AND THE KINGDOM OF  
DENMARK ON THE USE OF THE CORRECTIONAL INSTITUTION IN GJILAN FOR THE  
PURPOSE OF THE EXECUTION OF DANISH SENTENCES**

**MEMORANDUM OBJAŠNJENJA O NACRTU ZAKONA ZA RATIFIKCIJU TRAKTATA  
IZMEĐU REPUBLIKE KOSOVA I KRALJEVINE DANSKE ZA KORIŠĆENJE  
KOREKTIVNE USTANOVE U GNJILANU U SVRHU IZVRŠENJA DANSKIH KAZNI**

<p><b>1.Çështja kryesore e trajtuar në këtë projektligj</b></p> <p>Çështja kryesore e trajtuar në këtë projektligj është të ratifikoj Traktatin ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës për shfrytëzimin e Institucionit Korrektues në Gjilan me qëllim të ekzekutimit të dënimeve daneze, të nënshkruar nga Ministrat e Drejtësisë të të dy vendeve, më 26 prill 2022 në Prishtinë dhe 16 maj 2022 në Kopenhagë.</p> <p>Kjo Marrëveshje ka për qëllim të rregulloj çështjet që kanë të bëjnë ose që rrjedhin nga ekzekutimi i dënimeve daneze në Burg, dhe përcakton kushtet e nevojshme gjatë ekzekutimit të dënimeve daneze, përfshirë çështjet lidhur me azilin në Shtetin Pranues, si dhe procedurën, të drejtat dhe detyrimet e të dyja Palëve.</p> <p>Po ashtu përveç ekzekutimit të dënimeve daneze, mund ndihmohet në veçanti edhe në edukimin dhe trajnimin, shkëmbimin e praktikave dhe përvojave më të mira, fuqizimin e zbatimit të standardeve ndërkombëtare në shërbimet korrektuese, paraburgimin, si dhe mbështetjen dhe</p>	<p><b>1. The main issue addressed in this draft law</b></p> <p>The main issue addressed in this draft law is the ratification of the Treaty between the Republic of Kosovo and the Kingdom of Denmark on the use of the Correctional Institution in Gjilan for the purpose of the execution of Danish sentences, signed by the Ministers of Justice of both countries, on April 26, 2022 in Prishtina and May 16, 2022 in Copenhagen.</p> <p>This agreement is intended to regulate matters relating to or arising from the execution of Danish sentences in prison, and sets out the conditions necessary during the execution of Danish sentences, including matters relating to asylum in the Receiving State, as well as the procedure, rights and the obligations of both Parties.</p> <p>Also, in addition to the execution of Danish sentences, the agreement can particularly help with education and training, exchange of best practices and experiences, strengthening the implementation of international standards in correctional services, detention, as well as wider support and cooperation regarding</p>	<p><b>1. Glavno pitanje tretirano u ovom nacrt zakonu</b></p> <p>Glavno pitanje tretirano u ovom nacrtu zakona je ratifikacija Traktata između Republike Kosova i Kraljevine Danske o korišćenju Korektivne ustanove u Gnjilanu u svrhu izvršenja danskih kazni, koji su potpisali ministri pravde dveju zemalja, 26. aprila 2022. u Prištini i 16. maja 2022. u Kopenhagenu.</p> <p>Ovaj Sporazum ima za cilj da uređuje pitanja koja se odnose ili proizilaze iz izvršenja danskih kazni u Zatvoru, i utvrđuje neophodne uslove tokom izvršenja danskih kazni, uključujući pitanja koja se odnose na azil u državi prijema, kao i postupak, prava i obaveze obeju Strana.</p> <p>Takođe, pored izvršenja danskih kazni, može pomoći posebno u obrazovanju i obuci, razmeni najboljih praksi i iskustava, jačanju primene međunarodnih standarda u korektivnim službama, pritvoru, kao i široj podršci i saradnji u vezi sistema i mehanizma korektivne službe.</p>
---	---	--

<p>bashkëpunimin më të gjerë lidhur me sistemet dhe mekanizmat e shërbimit korrektues.</p> <p>Marrveshja po ashtu përcakton se cilat rregulla dhe rregullore zbatohen për ekzekutimin e dënimeve duke specifikuar se ankesat dhe çështjet ligjore lidhur me ekzekutimin e dënimeve daneze do të trajtohen nga autoritetet daneze, përfshirë gjykatat daneze ndërsa Rregullat dhe rregulloret e Shtetit Dërgues lidhur me punësimin, kujdesin shëndetësor, mjedisin e punës dhe sigurinë do të zbatohen për Stafin e Shtetit Dërgues.</p> <p>Sipas marrëveshjes Kosova do të vërë në dispozicion kapacitete të përshtatshme për 300 të Burgosur në Burg për të Burgosurit e Shtetit Dërgues. Hapësira do të jenë në formën e qelive individuale ose qelive në përputhje me rregullat dhe rregulloret e Shtetit Dërgues.</p> <p>Marrëveshja reflekton po ashtu praktikat më të mira evropiane dhe përbën një instrument ligjërish të detyrueshëm sipas ligjit ndërkombëtar dhe rregullohet me Konventën e Vjenës për të Drejtën e Traktateve (1969).</p>	<p>correctional service mechanisms and systems.</p> <p>The agreement also defines which rules and regulations apply to the execution of sentences by specifying that complaints and legal issues related to the execution of Danish sentences will be handled by the Danish authorities, including Danish courts, whereas the Sending State's rules and regulations regarding employment, health care, working environment and safety will apply to the Staff of the Sending State.</p> <p>According to the agreement, in prison Kosovo will make available capacities that are suitable for 300 prisoners of the Sending State. The premises shall be in the form of individual cells or cells in accordance with the rules and regulations of the Sending State.</p> <p>The agreement also reflects best European practices and constitutes a legally binding instrument under international law and is governed by the Vienna Convention on the Law of Treaties (1969).</p>	<p>Sporazum također utvrđuje koja pravila i propisi se primenjuju za izvršenje kazni precizirajući da će žalbe i pravna pitanja u vezi sa izvršenjem danskih kazni tretirati danske vlasti, uključujući danske sudove, dok pravila i propisi države pošiljaoca u vezi sa zapošljavanjem, zdravstvenom negom, radnom sredinom i bezbednošću primenjivaće se na osoblje države pošiljaoca.</p> <p>Prema sporazumu, Kosovo će staviti na raspolaganje odgovarajuće kapacitete za 300 zatvorenika u Zatvoru za zatvorenike države pošiljaoca. Prostorije će biti u obliku pojedinačnih ćelija ili ćelija u skladu sa pravilima i propisima države pošiljaoca.</p> <p>Sporazum također odražava najbolje evropske prakse i predstavlja pravno obavezujući instrument prema međunarodnom pravu i uređuje se Bečkom konvencijom o pravu ugovora (1969).</p>
--	--	--

<p><b>2. Objektivat dhe ndërlidhja e propozimit me prioritetet e Qeverisë</b></p> <p>Ky propozim ndërlidhet drejtpërdrejtë me objektivat e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe është i paraparë si objektiv në Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.</p> <p><b>3. Arsyetimi i propozimit</b></p> <p>Ministria e Drejtësisë duke u bazuar në aspiratën dhe zotimin e Republikës së Kosovës që të zhvillojë partneritet rajonal dhe evropian që do kontribuojë në afirmimin e vlerave evropiane në bashkëpunimin bilateral dhe rajonal, me qëllimi të ofrimit të mbrojtjes më efektive të të drejtave dhe interesave të shteteve palë të kësaj marrëveshjeje dhe shtetasve të tyre, ka kërkuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës miratimin në parim të kësaj nisme</p> <p>Në bazë të Vendimit të Qeverisë Nr. 28/19 të datës 14.07.2021, Ministria e Drejtësisë ka zhvilluar negociatat me akterët relevant për arritjen e kësaj marrëveshjeje.</p>	<p><b>2. Objectives and correlation of the proposal with the Government's priorities</b></p> <p>This proposal is directly related to the objectives of the Government of the Republic of Kosovo and is foreseen as an objective in the National Plan for the Implementation of the SAA.</p> <p><b>3. Justification of the proposal</b></p> <p>The Ministry of Justice based on the aspiration and commitment of the Republic of Kosovo to develop a regional and European partnership that will contribute to the affirmation of European values in bilateral and regional cooperation, with the aim of providing the most effective protection of the rights and interests of the state parties to this agreement and their citizens, has requested from the Government of the Republic of Kosovo to approve this initiative in principle.</p> <p>Based on the Government Decision No. 28/19 of 14.07.2021, the Ministry of Justice has conducted negotiations with the relevant actors in order to reach this agreement.</p>	<p><b>2. Ciljevi i povezivanje predloga sa prioritetima Vlade</b></p> <p>Ovaj predlog je direktno povezan sa ciljevima Vlade Republike Kosova i predviđen je kao cilj u Nacionalnom planu za sprovođenje SSP-a.</p> <p><b>3. Obrazloženje predloga</b></p> <p>Ministarstvo pravde zasnivajući se na težnji i posvećenosti Republike Kosova da razvije regionalno i evropsko partnerstvo koje će doprineti afirmaciji evropskih vrednosti u bilateralnoj i regionalnoj saradnji, u cilju obezbeđivanja efikasnije zaštite prava i interesa država potpisnica ovog sporazuma i njihovih građana, zatražio je od Vlade Republike Kosova da načelno odobri ovu inicijativu</p> <p>Na osnovu Odluke Vlade br. 28/19 od 14.07.2021.godine, Ministarstvo pravde je vodilo pregovore sa relevantnim akterima za postizanje ovog sporazuma.</p>
--	--	--

<p><b>4. Listën e plotë të akteve ligjore të BE që duhet të përfshihen në projekt-aktin ligjor si burime informuese (nëse është e aplikueshme):</b></p> <p>Projektligji ka formën dhe strukturën standarde në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe është në pajtim me interesin e përgjithshëm të Kosovës dhe popullit të saj. Projektligji nuk ka elemente diskriminuese. Është i përgatitur në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Projektligji është në harmoni të plotë me <i>acquis communautaire</i>, në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.</p>	<p><b>4. The complete list of EU legal acts to be included in the draft legal act as information sources (if applicable):</b></p> <p>The draft law has the standard form and structure in accordance with the Constitution of the Republic of Kosovo and is in accordance with the general interest of Kosovo and its people. The draft law has no discriminatory elements. It is prepared in Albanian, Serbian and English. The draft law is in full harmony with the <i>acquis communautaire</i>, in accordance with the Stabilization-Association Agreement.</p>	<p><b>4. Potpunu listu pravnih akata EU koji će biti uključeni u nacrt pravnog akta kao izvori informacija (ako je primenljivo):</b></p> <p>Nacrt zakona ima standardnu formu i strukturu u skladu sa Ustavom Republike Kosova i u skladu je sa opštim interesom Kosova i njegovog naroda. Nacrt zakona nema diskriminatornih elemenata. Pripremljen je na albanskom, srpskom i engleskom jeziku. Nacrt zakona je u punoj saglasnosti sa <i>ackuis communautaire</i>, u skladu sa Sporazumom o stabilizaciji i pridruživanju.</p>
<p><b>5. Pasojat e të gjitha opsioneve të shqyrtuara (përfitimet dhe pasojat negative, kosto buxhetore, përshtatshmëria administrative dhe e zbatimit si dhe kostot dhe pasojat tjera).</b></p> <p>Kjo marrëveshje nuk paraqet kosto shtesë, madje tarifa për shfrytëzimin e Burgut të Gjilanit është paraparë të jetë një shumë vjetore e vazhdueshme fikse prej 15,000,000 € (pesëmbëdhjetë milionë), e cila do të vihet</p>	<p><b>5. Consequences of all options reviewed (benefits and negative consequences, budgetary costs, administrative and implementation feasibility as well as other costs and consequences).</b></p> <p>This agreement does not represent additional costs. In fact, the fee for the use of the Gjilan Prison is foreseen to be a fixed annual amount of €15,000,000 (fifteen million), which will be made available to the Receiving State in</p>	<p><b>5. Posledice svih razmatranih opcija (koristi i negativne posledice, budžetski troškovi, administrativna i implementaciona adekvatnost kao i drugi troškovi i posledice).</b></p> <p>Ovaj sporazum ne uključuje dodatne troškove, čak je i tarifa za korišćenje zatvora u Gnjilanu predviđena da bude kontinuirani godišnji fiksni iznos od 15.000.000 evra (petnaest miliona), koji će biti stavljen na</p>

<p>në dispozicion të Shtetit Pranues në shuma tremujore prej 3,750,000 € (tre milionë e shtatëqind e pesëdhjetë mijë).</p>	<p>quarterly amounts of €3,750,000 ( three million seven hundred and fifty thousand).</p>	<p>raspolaganje državi prijema u tromesečnim iznosima od 3.750.000 evra. (tri miliona sedamsto pedeset hiljada).</p>
<p><b>6. Konsultimi (kush është konsultuar dhe përmbledhje të shkurtra të përgjigjeve):</b></p>	<p><b>6. Consultation (who was consulted and brief summaries of responses):</b></p>	<p><b>6. Konsultacije (ko je konsultovan i kratki rezimei odgovora):</b></p>
<p>Në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 04/L-052 për marrëveshjet ndërkombëtare.</p>	<p>Pursuant to Article 10 of Law no. 04/L-052 on International Agreements.</p>	<p>Na osnovu člana 10. Zakona br. 04/L-052 o međunarodnim sporazumima.</p>
<p><b>7. Mënyra e komunikimit të politikës së re për publikun:</b></p>	<p><b>7. Manner of communicating the new policy to the public:</b></p>	<p><b>7. Način saopštavanja nove politike javnosti:</b></p>
<p>Në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 04/L-052 për marrëveshjet ndërkombëtare.</p>	<p>Pursuant to Article 10 of Law no. 04/L-052 on International Agreements.</p>	<p>Na osnovu člana 10. Zakona br. 04/L-052 o međunarodnim sporazumima.</p>
<p><b>8. Projektvendimi i Qeverisë</b></p>	<p><b>8. Government draft decision</b></p>	<p><b>8. Nacrt odluka Vlade</b></p>
<p>Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/17 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria</p>	<p>Pursuant to Article 92 paragraph 4 and Article 93 paragraph 4 of the Constitution of the Republic of Kosovo, based on Article 4 of Regulation no. 02/2011 on the Areas of Administrative Responsibility of the Office of Prime Minister and Ministries, amended and supplemented by Regulation no. 07/2011 and Regulation no. 14/17 as well as based on article 19 of the Rules of Procedure of the Government of the Republic of Kosovo no. 09/2011, the Government of the Republic of</p>	<p>U skladu sa članom 92 stav 4 i članu 93 stav 4 Ustava Republike Kosova, na osnovu člana 4 Uredbe br. 02/2011 o oblastima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstava, izmenjene i dopunjene Uredbom br. 07/2011 i Uredbe br. 14/17 kao i sa članom 19 Poslovnika Vlade Republike Kosova br. 09/2011, Vlada Republike Kosova je na sednici održanoj xx/xx/2021, donela ovu:</p>

<p>e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më xx/xx/2021, nxjerr këtë:</p> <p style="text-align: center;"><b>VENDIM</b></p> <p>1. Miratohet Projektligji për Ratifikimin e Traktatit Ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës për Shfrytëzimin e Institucionit Korrektues në Gjilan me Qëllim të Ekzekutimit të Dënimeve Daneze.</p> <p>2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t’ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.</p> <p>3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit</p>	<p>Kosovo at its meeting held on xx/xx/2021, issued the following:</p> <p style="text-align: center;"><b>DECISION</b></p> <p>1. The Draft Law on the Ratification of the Treaty Between the Republic of Kosovo and the Kingdom of Denmark on the Use of the Correctional Institution in Gjilan for the Purpose of the Execution of Danish Sentences is hereby approved.</p> <p>2. The Secretary General of the Office of Prime Minister is obliged to forward the draft law from point 1 of this Decision to the Assembly of the Republic of Kosovo for review and approval.</p> <p>3. The decision enters into force on the day of its signing.</p>	<p style="text-align: center;"><b>ODLUKU</b></p> <p>1. Usvaja se Nacrt zakona o ratifikaciju Traktata između Republike Kosova i Kraljevine Danske o korišćenju Korektivnih ustanova u Gnjanu u svrhu izvršenja danskih kazni.</p> <p>2. Generalni sekretar kancelarije premijera se obavezuje da nacrt zakona iz tačke 1. ove odluke prosleđuje Skupštini Republike Kosova na razmatranje i usvajanje.</p> <p>3. Odluka stupa na snagu danom potpisivanja.</p>
--	--	--